

V E N D I M N r 1

Datë 25/05/2018

I Asamblesë së Aksionereve të Shoqërisë “ TV KLAN ” SH.A

PËR

“NISJEN E PROCEDURAVE TË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE
TË SHOQËRISË “TV KLAN” SH.A

ME

SHOQËRINË “ TNSH”sh.p.k

1. Bazuar në ligjin nr.9901, datë 14/04/2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar); ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 për “Regjistrimin e Biznesit” (i ndryshuar); ligjin nr.131/2015, datë 26.11.2015 për “Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe mbështetur në Statutin e shoqërisë, sot më datë 25/05/2018, në selinë e shoqërisë “**TV KLAN**” sh.a u mbledh Asambleja e Aksionereve të Shoqërisë, me pjesëmarrjen e aksionereve Z.Aleksander FRANGAJ pjesmarres me 60% te kapitalit aksionar te shoqerise dhe Alba Gina pjesmarres me 40% te kapitalit aksionar te shoqerise., me rend dite



Nisja e procedurave të Bashkimit me përthithje të shoqërisë “**TV KLAN**” sh.a me shoqërinë **TNSH**sh.p.k., ku shoqëria “**TV KLAN**” sh.a do të jetë shoqëria **Përthithëse** dhe shoqëria “**TNSH**”sh.p.k., do të jetë shoqëria e **Përthithur**.

Pas shqyrtimit të çështjes së mësipërme ortaket e shoqërisë:

V E N D O S E N

1. Miratimin e nisjes së procedurave të bashkimit me përthithje të shoqërive, “**TNSH**” sh.p.k me shoqërinë “**TV KLAN**” sh.a, ku shoqëria “**TV KLAN**” sh.a, do të jetë **shoqëria Përthithëse** dhe shoqëria “**TNSH**”sh.p.k., do të jetë **shoqëria e Përthithur**.
2. Caktimin e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “**TV KLAN**” sh.a të hartojë **Projekt - Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje** duke u bazuar në nenin 216 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe publikimin e saj sipas kërkesave të ligjit të sipër cituar; Ligjit nr.9723, date 03/05/2007 për “Regjistrimin e Biznesit” dhe ligjit nr.131/2015 për “Qendrën Kombëtare të Biznesit”.
3. Duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi dhe deri më datën e realizimit të bashkimit me perthithje ,shoqëria do të jetë në “**Periudhën Tranzitore**”.
4. Pas firmosjes së **Projekt Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje**, përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe keshilli mbikqyres I “**TV KLAN**”sh.a, do ia paraqesë atë Asamblesë së Aksionereve për miratim, në mënyrë që të përfundojë procedura e bashkimit.


Adresa: rruga “Aleksander Moisiu”, ish Kinostudio, Tiranë, Shqipëri




5. Emerohet Eksperti kontabel Z.Sanije Tafa perfaqesuese e studios Asie Shpk per te pergatitur raportin e ekspertit kontabel e per te ndjeku proceduren e perthithjes.
6. Ngarkohet Administratori i shoqërisë "TV KLAN" sh.a, për zbatimin e këtij vendimi sipas ligjit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONERET E SHOQERISE

ALEKSANDER FRANGAJ



ALBA GINA



Handwritten text, possibly a signature or address, located in the lower-left quadrant of the page.



V E N D I M

Datë 25/05/2018

i Asamblesë së Ortakut te vetem të Shoqërisë "TNSH" sh.p.k.

PËR
"NISJEN E PROCEDURAVE TË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE
TË SHOQËRISË "TNSH" SH.P.K.
ME
SHOQËRINË "TV KLAN" SH.A"

1. Bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar); ligjin nr.9723, datë 03/05/2007 për "Regjistrimin e Biznesit" (i ndryshuar); ligjin nr.131/2015, datë 26.11.2015 për "Qendrën Kombëtare të Biznesit"; si dhe mbështetur në Statutin e shoqërisë, sot më datë 25/05/2018, në selinë e shoqërisë "TNSH" sh.p.k. me pjesëmarrjen e ortakut të vetëm të shoqërisë, me 100% të kapitalit Zj Alba Gina, me rend dite:

Nisja e procedurave të Bashkimit me përrthithje të shoqërisë "TNSH" sh.p.k. me shoqërinë "TV KLAN" sh.a, ku shoqëria "TV KLAN" sh.a do të jetë shoqëria Përrthithëse dhe shoqëria "TNSH" sh.p.k., do të jetë shoqëria e Përrthithur.

Pas shqyrtimit të çështjes së mësipërme ortaku i vetëm i shoqërisë:

V E N D O S I:

1. Miratimin e nisjes së procedurave të bashkimit me përrthithje të shoqërive "TNSH" sh.p.k. ,me shoqërinë "TV KLAN" sh.a, ku shoqëria "TV KLAN" sh.a., do të jetë shoqëria Përrthithëse dhe shoqëria "TNSH" sh.p.k., do të jetë shoqëria e Përrthithur.
2. Caktimin e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë "TNSH" sh.p.k., të hartojë projekt Marrëveshjen e Bashkimit me Përrthithje duke u bazuar në nenin 216 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe publikimin e saj sipas kërkesave të ligjit të sipërcituar; Ligjit nr.9723, datë 03/05/2007 për "Regjistrimin e Biznesit" dhe ligjit nr.131/2015 për "Qendrën Kombëtare të Biznesit".
3. Duke filluar nga data e marrjes së këtij vendimi dhe deri më datën e realizimit të bashkimit, shoqëria do të jetë në "Periudhën Tranzitore".
4. Pas firmosjes së Projekt Marrëveshjes së Bashkimit me Përrthithje, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë "TNSH" sh.p.k., do ia paraqesë atë Asamblesë së aksionereve për miratim, në mënyrë që të përfundojë procedura e bashkimit.

5. Emerohet Eksperti kontabel Z.Sanije Tafa perfaqesuese e studios Asie Shpk per te pergatitur raportin e ekspertit kontabel e per te ndjeku proceduren e perthithjes
6. Ngarkohet Administratori i shoqërisë "TNSH" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi sipas ligjit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

"TNSH" sh.p.k

Alba Gina

Alba Gina

